



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.977/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Auto Mita shpk, me seli ne fshatin Preoc Magjistrala Prishtinë-Shkup, me numër identifikues 810816481, ndaj debitorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP nr.1359/22 dt.18.05.2023, me datën 05.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP nr.1359/22 dt.18.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP nr.1359/22 dt.18.05.2023, e ka Refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Prishtinë, ndërsa Urdhrin Përmbarimor te Përmbarueses Private Rrezarta Metaj, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, P.517/21 dt.01.12.2021 e ka Lënë në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës jokontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që dhomat e shkallës se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta prish dhe ta heq nga fuqia juridike Urdhrin përmbarimor, dhe lëndën ta kthej në shkallë të parë në rigjykim.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Auto Mita” shpk me numër identifikues 810816481, me seli ne fshatin Preoc Magjistrala Prishtinë-Shkup, me datën 01.12.2021 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.21-SHV01-L-282 dt.22.03.2021. Përmbartuesja Private Rrezarta Metaj nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhër për lejimin e përmbartimit P.nr.517/21 dt.01.12.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura ti paguaj shumën prej 900.60 euro me kamatëvonesë prej 8% ne vit duke filluar nga data e kalimit te afatit për pagesë e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit, me datën 13.12.2021, debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se e kundërshton propozimin për përmbartim sepse debitori propozimin e ka pranuar me datën 03.12.2021 sa i përket vlerës prej 900.60 euro, por se shton se lënda me nr. CPO nuk e ka raportin e policisë dhe nuk është e kompletuar me dokumentet e nevojshme ashtu qe nuk ka bazë për procedim më tutje, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 16.12.2021, me arsyetimin se urdhri përmbartimor është lejuar ne bazë te dokumentit te besueshëm –Faturë, e cila përmban te gjitha elementet e parapara me ligj te procedurës përmbartimore, dhe është konform nenit 29 te LPP. Sa i përket pretendimit te debitorit se lënda nuk e ka raportin e policisë, vlerëson se kjo është çështje administrative e debitorit, automjeti është dërguar tek kreditorit nga debitori dhe ne lidhje me shkaktarin e aksidentit nuk ka fare kontest ngase debitori dhe kreditori kanë komunikuar zyrtarisht përmes e-malit te cilën gjykatës ia bashkëngjisim si provë. Është absurde te pretendohet se automjeti i aksidentuar nga ana e zyrtarëve te debitorit te sjellët për riparim ne sallonin e kreditorit dhe fatura te mbetet e papaguar ndaj kreditorit për shkak se debitorit nuk i përgjigjet kompania e sigurimeve, Prapësimi i debitorit është i pabazuar ngase nuk mbështet ne asnjë provë ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, andaj propozon që gjykata ta refuzoj si te pathemeltë prapësimin debitorit dhe urdhri përmbartimor te mbetet ne fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1359/22 dt.18.05.2023, me të cilin e ka Refuzuar ne tërësi prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar sepse nga shkresat ne lende konstaton se fatura e bashkangjitur propozimit për përmbartim nga kreditori është ne origjinal dhe ka te gjitha

elementet përmbajtësore konform nenit 29 dhe 37 të LPP. Andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore për anulim të urdhrit përmbarrimor nga neni 71 ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i dhomës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 të LPK dhe nuk ka zbatim të gabuar dhe jo të potë të gjendjes faktike kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Dhomat e shkallës së dytë, po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, sepse fatura nr.21-SHV01-L-282 dt.22.03.2021, mbi bazën e se cilës është lejuar përmbarrimi është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për ekzekutim, konform me nenin 37 i LPP-së, i cili thotë se *“kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, e që në rastin konkret kjo faturë i është bashkëngjitur propozimit për përmbarrim në origjinal, ka vulën e pranimit të debitorit, me nr. Protokollin 03FIN 2423 dt. 24.03.2021, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimit të një dokumenti në mënyrë të rregullt. Dhomat e shkallës së dytë analizoi pretendimet ankimore të debitorit por i vlerësoi si jo relevante për një vendosje ndryshe sepse nuk janë të argumentuara me prova konkrete juridike siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, ashtu që si të tilla i refuzoi ndërsa vendimin e dhomës së shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.977/23, me datë 05.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha